

**KARTELË INFORMATIVE**

**AL105047**

<b>1. Emri i shërbimit</b>	Kërkesë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi modelin e përdorimit			
<b>2. Cili është qëllimi i shërbimit?</b>	Pronari i një modeli përdorimi mund t'ia kalojë të drejtat e Pronësisë një personi tjetër nëpërmjet një kontrate transferimi pronësie. Kjo Kontratë bëhet e vlefshme pas regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).			
<b>3. Çfarë ofron ky shërbim?</b>	<p>Çdo kontratë për ndryshim pronësie të një modeli përdorimi bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët kontraktuese, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.</p> <p>Çdo ndryshim pronësie i një patente kryhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Në rast kalimi të pronësisë së një patente, ndryshimi regjistrohet në regjistrin e patentave. Pronari i patentës ka të drejtë të fillojë një proces gjyqësor për patentën, vetëm nëse ndryshimi i pronësisë është i regjistruar në këtë regjistrë. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), boton ndryshimet në pronësinë e patentave.</p> <p>Kalimi i pronësisë së patentës ka efekte ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit të kalimit të kësaj pronësie në regjistrin e patentave. Megjithatë, kalimi i pronësisë përpara regjistrimit vlen për palët e treta, të cilat i kanë fituar të drejtat për patentën pas datës së këtij kalimi, edhe pse ishin në djeni për këtë kalim në datën në të cilën ato i fituan të drejtat.</p>			
<b>4. A jam përfitues?</b>	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka bërë një model përdorimi.			
<b>5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?</b>	<b>Nr</b>	<b>Lloji</b>	<b>Dokumenti lëshohet nga:</b>	<b>Dorëzohet në sportel nga aplikanti?</b>
	1	Formular aplikimi për kërkesë ndryshimi pronari	Aplikanti / Institucioni	Po
	2	Mandatpagesa e tarifës përkatëse	Banka	Po
	3	Dokumenti që vërteton ndryshimin e pronarit	Aplikanti	Po
	4	Autorizimi i përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës	Aplikanti	Po
<b>6. Ku mund të aplikoj?</b>	<b>Zyrat pritëse</b> Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	<b>Qyteti</b> Tiranë	<b>Adresa</b> Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	<b>Orari</b> E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
<b>7. A është ky shërbim online?</b>	<b>Niveli 1</b> Ofrohet informacion mbi shërbimin	<b>Niveli 2</b> Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	<b>Niveli 3</b> Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	<b>Niveli 4</b> Shërbimi ofrohet tërësisht online
<b>8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?</b>	<b>Tarifa bazë</b> 4000 lekë	<b>Tarifa shtesë</b>	<b>Tarifa Online</b>	<b>Mënyra e pagesës</b> Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
<b>9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?</b>	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit			
<b>10. Çfarë përfitoj?</b>	Njoftim			
<b>11. Ç'afat vlefshmërie ka?</b>	Pa afat, për aq kohë sa nuk ka një ndryshim pronësie të mëvonshëm.			
<b>12. Ku e marr?</b>	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
<b>13. Cili është institucioni përgjegjës?</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
<b>14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?</b>	<b>Kontaktto në:</b> E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: <b>0800 0118</b>		<b>Orari</b> Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
<b>15. Nëse kam ankesë, si të veproj?</b>	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
<b>16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?</b>	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores "Për lëshimin e patentave për shpikje dhe modelet e përdorimit", e ndryshuar; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar.			